



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**  
**Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality**

---

**- Kuvendi Komunal**  
**01 Nr.06-1477/4**  
**Dt.26.09.2013**  
**D r a g a s h**

Kuvendi Komunal i Dragashit, në bazë të nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 32.2 të Statutit të Komunës-Dragash, konform shkresave e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (II Nr.0201-51511 të dt.28.06.2012) dhe të Ministrisë së Bujqësisë,Pylltarisë dhe Zhvillit Rural (Nr.2142 të dt.27.06.2012,) për vlerësim të ligjshmërisë së Vendimit të Kuvendit Komunalë Dragash 01 Nr.06-649/2 të dt.03.05.2012 , për menaxhimin e gjahishtave në territorin e Komunës së Dragashit,në seancën e dt.26.09.2013, miraton këtë:

## V E N D I M

- I. ANULOHET** Vendimi 01 Nr.06-649/2 i dt.03.05.2012 i Kuvendit Komunal të Dragashit lidhur me menaxhimin e gjahishtave në territorin e Komunës së Dragashit, i cili konsiderohej se ishte miratuar në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit për Gjuetinë 02/L-53 i dt.16.12.2005,Udhëzimin Administrativ nr.10/2007 “ Kriteret e caktimit të zonave dhe procedurat për themelimin e vendgjuetive” dhe Udhëzimin Administrativ nr.06/2009 “Për dhënien në menaxhim të vendgjuetive të përbashkëta”,si dhe procedurat e tenderimit.
- II. AUTORIZOHET** Drejtorati për Bujqësi,Pylltari,Zhvillim Rural e Inspeksion i Komunës Dragash që lidhur me menaxhimin e gjahishtave në teritorin e Komunës-Dragash të ndërmer masat e nevojshme të parapara me dispozitat e Ligjit për Gjuetinë dhe udhëzimet e cekura administrative në pikën I të këtij Vendimi..
- III.** Për hapat e ndërmarr të njoftohet kryetari Komunës dhe Kuvendi Komunal-Dragash.

### *A r s y e t i m*

Kuvendi Komunal i Dragashit,në seancën e rregullt të dt.03.05.2012,duke shqyrtuar kërkesat paralele të 2 shoqatave të gjahtarëve “Malet e Sharrit dhe “Dhija e Egër” (të dyja me seli në Dragash) ka miratuar Vendimin 01 Nr.06-649/2, për menaxhimin e gjahishtave në territorin e Komunës së Dragashit, pa u lëshuar në respektimin e dispozitave ligjore të Ligjit të larpërmendur dhe të udhëzimeve administrative të cilat rregullojnë këtë lëmi,si dhe pa u aplikuar procedura e tenderimit.

Andaj,duke u patuar parasysh faktet e lartcekura, Kuvendi Komunal i Dragashit, në seancën e dt.26.09.2013 vendosi si në pikat I-III të këtij Vendimi.

Shtojcë: Vendimi kontestues 01 Nr.06-649 i KK-së Dragash i dt.03.05.2012,shkresat e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal... dhe të Ministrisë së Bujqësisë,Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural(Departamenti i Pylltarisë)....për vlerësim të ligjshërisë.

I dërgohet:

- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (Zyrës Ligjore)-Prishtinë,
- Ministrisë së Bujqësisë,Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural(Departamentit të Pylltarisë)-Prishtinë,
- Shoqatave të Gjahtarëve “Malet e Sharrit” & “Dhija e Egër”-Dragash,
- Drejtoratit për Bujqësi,Pylltari, Zhvillim Rural e Inspekcion-Dragash,
- Kryetarit të Komunës-Dragash, dhe
- Arkivit



**KUVENDI KOMUNAL-DRAGASH**

**Kryesuesi**

*Shaban Shabani*